



UNMIK/DIR/2006/11
23 qershor 2006

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2006/11

**PËR ZBATIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 1999/21 MBI
LICENCIMIN, MBIKËQYRJEN DHE RREGULLIMIN E BANKAVE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë sipas Rregullores së ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik mbi autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe në pajtim me nenin 50 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/21 të datës 15 nëntor 1999 mbi licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave,

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/20 të datës 15 nëntor 1999, e cila është ndryshuar përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/24 të datës 1 tetor 2001,

Me qëllim të rregullimit të procedurave të pagesës së depozitave të papaguara që duhet të paguhen gjatë likuidimit të bankës në përputhje me nenin 43 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/21,

Nxjerr Urdhëresën administrative si në vijim:

Neni 1
Procedura e pagesës

1. Pagesat e depoziteve që duhet të bëhen në përputhje me nenin 43.1 (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/21 (Rregullorja) nga shumat që janë në dispozicion të likuidatorit bëhen pa ndonjë vonesë të paarsyeshme. Pagesat që duhet të bëhen sipas nenit 43.2 të Rregullores bazohen në kuotën e caktuar nga likuidatori në pajtim me parimin e trajtimit të barabartë të depozitave të së njëjtës klasë.
2. Nëse shumat në dispozicion pas likuidimit të aseteve të bankës nuk janë të mjaftueshme për pagesën e të gjitha depozitave të papaguara sipas nenit 43.1 (c), depozitet e tilla do të paguhen nga fondet në dispozicion të likuidatorit sipas një kuote fillestare të caktuar nga likuidatori në bazë të një përlllogaritjeje të drejtë të të gjitha

shumave që mund të fitohen në mënyrë të arsyeshme nga procesi i likuidimit gjatë periudhës pesëvjeçare pas fillimit të likuidimit.

Neni 2

Bërja e pagesave të kohëpaskohshme

1. Pagesat që duhet të bëhen nga likuidatori në përputhje me nenin 1 më lart do t'i bëhen çdo pretenduesi përnjëherë apo në disa shuma që nuk tejkalojnë 20.000,00 € (njëzet mijë euro) dhe do të bëhen atëherë kur likuidatori të ketë fonde të mjaftueshme në dispozicion për shpërndarje të shumave të njëjta për të gjithë pretenduesit.
2. Pagesat për depozite nuk do të tejkalojnë kuotën e përcaktuar nga likuidatori sipas nenit 1 më lart. Nëse shuma e të gjitha fondeve të marra gjatë procesit të likuidimit e tejkalon kuotën e përlogaritur nga likuidatori për pagesat e depoziteve, teprica mbi atë kuotë do t'u shpërndahet të gjitha depozitave në mënyrë të barabartë.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 23 qershor 2006.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm